



DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL
DIREKCIJA ZA POLJOPRIVREDU I RURALNI RAZVOJ
DIRECTORATE FOR AGRICULTURE AND RURAL DEVELOPMENT

Data/Datum/Date:	24.07.2024
Nr./Br./No	12/15
Nga/Od/From:	Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural: Gojart Bajrami
Lënda/Predmet/Subject:	Thirrje për aplikim

Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale neni 61 paragrafi 62.3, Rregullores Nr.01-060/01-24495/17 për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve neni 5 paragrafin 5.1 dhe 5.2, neni 19 paragrafi 19.1, 19.2.4, bënë këtë:

Thirrje për aplikim

Ftohen të gjithë fermerët kultivues të lopëve qumështore dhe mështjerrave për mbarështim, të aplikojnë në këtë thirrje për këto kategori të kafshëve:

1. Kultivues të lopëve qumështore prej 3 e më shumë krerë
2. Kultivues të mështjerrave të moshës 14 deri 20 muaj, prej 1 e më shumë krerë

Kriteret që duhet të plotësoj aplikuesi janë:

- Të jetë banorë rezident i Komunës së Shtimes
- Aplikues për subvencione (pagesa direkte) për vitin 2024 me 5 e më shumë krerë, ndërsa ata me 3 dhe 4 krerë, aplikojnë vetëm me vërtetim dhe listë të veterinarit
- Të jenë të regjistruar në Regjistrin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës (Veterinari)

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Kopja e dokumentit identifikues të Republikës së Kosovës
- Kopja e formularit për aplikim në subvencione 2024 (Vlen për ata që kanë aplikuar për Pagesën Direkte 2024)
- Lista dhe Vërtetimi nga veterinari për numrin e kafshëve
- Konfirmimi bankar
- Dëshmia e pagesës së tatimit në pronë
- Aplikacioni i plotësuar

Afati për aplikim: 24 Korrik 2024 – 09 Gusht 2024

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën pritëse